



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Raport vjetor për vitin 2015 mbi
zbatimin e Strategjisë Qeveritare
dhe Planit të Veprimit për
bashkëpunim me shoqërinë civile
2013-2017

Janar 2016 Prishtinë

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Kemi kënaqësinë që t'ju dorëzojë raportin e parë mbi zbatimin e Strategjisë Qeveritare dhe Planit të Veprimit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile gjatë vitit 2015. Besojmë se ky raport do të ofrojë një pasqyrë të qartë rreth progresit të arritur në rrugën tonë drejt përmirësimit të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile, në dallimin e aktiviteteve dhe objektivave që kërkojnë vëmendje më të madhe për realizimin e tyre, ofrimin e zgjidhjeve që ne t'iu qasemi më mirë këtyre problemeve, si dhe për masat që duhen ndërmarrë nga institucionet për arritje të synimeve që i kemi vënë vetes si institucione në procesin e bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile.

Kjo përmbledhje pasqyron qartë ndikimin e të arriturave, përpjekjet e institucioneve, shoqërisë civile, synimin e të gjithë neve për të përmirësuar gjendjen e bashkëpunimit të institucioneve me shoqërinë civile dhe Këshillit si trupë monitoruese. Gjithashtu, ne i kemi identifikuar edhe sfidat që janë hasur dhe që presim t'i hasim në këtë rrugëtim, veprimet të cilat duhet t'iu delegohen me urgjencë aktorëve përgjegjës për ta përmirësuar gjendjen ku ne jemi, për t'i korrigjuar gabimet dhe për të vendosur standarde për të gjithë ne që jemi të përfshirë në procesin e bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile.

E gjithë puna e koordinimit të procesit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare dhe Planit të Veprimit për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është realizuar nga z. Habit Hajredini, Drejtor në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, në bashkëpunim dhe përkrahje nga stafi i zyrës dhe të gjitha institucionet e përfshira në proces.

Kjo përmbledhje e raportit është përgatitur nga znj.Trëndelinë Dreshaj, zyrtare e lartë në Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit, në cilësinë Sekretariatit të Këshillit për zbatimin e Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, në bashkëpunim të ngushtë me zyrat përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit, ministritë e linjës, CiviKos-in si dhe koordinatorët e ekipeve dhe ekipet e punës të këtij Këshilli.

Ju falënderojë për mbështetjen dhe punën e deritanishme në këtë proces.

Me respekt

z. Habit Hajredini, Drejtor në ZQM/ZKM

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 05.07.2013 ka aprovuar Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Bazë për hartimin e kësaj strategjie kanë qenë dhe janë prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për politika më të mira publike, llogaridhënie e transparencë, besim më të madh të publikut dhe rritje të legjitimitetit.

Kjo Strategji, nëpërmjet masave konkrete të parapara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, i ngarkon institucionet dhe aktorët e caktuar qeveritar me obligime konkrete të cilat duhet të përmbushen brenda afateve të caktuara kohore. Përcaktimi i institucioneve bartëse të veprimeve të ndryshme mundëson që masat e parapara të kenë adresën e caktuar për t'u zbatuar dhe për të kërkuar përgjegjësi. Për më tepër, masat dhe veprimet e veçanta do të ndërmerren në kuadër të një kornize gjithëpërfshirëse, e cila do të koordinohet nga një njësi e vetme qendrore. Kjo do ta evitojë qasjen parciais dhe jo të standardizuar, duke e rritur vlerën e secilit veprim të veçantë në raport me objektivat strategjike në përgjithësi.

Sa i përket fushës së veprimit të mbuluar më Strategji, ajo fokusohet kryesisht në çështjet horizontale që e prekin bashkëpunimin në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile. Edhe pse adreson çështje të përgjithshme, kjo Strategji megjithatë përcakton parime të përgjithshme të bashkëpunimit të cilat në të ardhmen duhet të aplikohen edhe në çështjet specifike të sektorëve të caktuar.

Në proces të zbatimit të Strategjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 02.04.2014 Nr. 04/181 ka marrë Vendim për themelimin e Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Këshilli është struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës përfaqësimi i ministrive do të jetë i nivelit të Sekretarëve të Përgjithshëm. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit, dhe do të jetë në funksion për të organizuar, zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit. Ky Këshill në përbërjen e tij ka 29 anëtarë nga të cilët 15 janë përfaqësues të shoqërisë civile dhe 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Brenda Këshillit, ekzistojnë katër ekipe punuese, ku secili përqendrohet në njënjë prej objektivave strategjike të Strategjisë. Secili ekip punues ka caktuar një Koordinator që koordinon ekipin dhe përgatit një raport për Sekretariatit e Këshillit pas secilit takim tremujor të Këshillit. Të gjitha institucionet po ashtu janë të obliguara të ofrojnë çfarëdo të dhënash të kërkuara nga Sekretariati, CiviKos-i, apo koordinatorët e ekipeve punuese në lidhje me zbatimin e Strategjisë.¹

Zyra për Qeverisje të Mirë shërben si Sekretariat i Këshillit dhe është përgjegjëse për “monitorim dhe raportim e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit”.² Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit është e obliguar të publikojë raportin për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në baza vjetore.”³ Këshilli po ashtu mund të marrë parasysh raportet e monitorimit të pavarur të përgatitura nga CiviKos-in ose OShC-të tjera.

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovë sipas Planit të Punës për vitin 2015 për Këshillin për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, është e ngarkuar për përgatitjen e metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë.

Qëllimi kryesor për krijimin e metodologjisë për Monitorim dhe Raportim është të lehtësohet monitorimi i progresit në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Strategjia mbulon një periudhë prej pesë vitesh, ndërsa Plani i Veprimit mbulon vetëm tri vitet e para të Strategjisë. Plani për vitin 2015 është hartuar në fund të vitit 2014 dhe në përputhje me këtë tani është në proces hartimi i Planit të ri të Veprimit për vitin 2016. Duhet theksuar se për shkak të vonesave në fillimin e zbatimit të Planit të Veprimit 2013-2015 shumica e veprimeve dhe rezultateve janë bartur në vitet 2015-2017. Përndryshe në fund të këtij viti Këshilli dhe të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces do të vendosin për një rishikim të përgjithshëm të kësaj Strategjie dhe do ta përshtatësin atë me Planin e Veprimit.

Sipas “Rregullave të Punës së Këshillit për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile” Këshilli do të miratojë udhëzimet raportuese,

¹ Qeveria e Kosovës, Këshilli për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, “Vendimi për themelimin e ekipeve punuese për të siguruar zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017”, 10 Nëntor, 2014.

² Zyra e Kryeministrit, “Rregullat e Procedurës së Këshillit për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile,” paragrafi IV, 1.

³ Po aty, IV. 3.

të hartuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë për mbledhjen e të dhënave nga autoritetet përgjegjëse.

Zyra për Qeverisje të Mirë e ka përgatitur një “Kornizë për Monitorim dhe raportim M&R” të cilën institucionet përgjegjëse duhet ta përdorin për të raportuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Matrica gjegjësisht procesi i raportimit ka qenë i paraparë të përditësohet në takimet tremujore të Këshillit. Megjithatë, Këshilli mori vendim që përditësimet të ofrohen vetëm dy herë në vit pra, raportet të përgatiten çdo gjashtë muaj. Në përputhje me këtë Sekretariati tashmë ka përgatitur një raport monitorues gjashtë-mujor për periudhën Janar-Qershor 2015, duke përdorur matricën e Planit. Sekretariati po ashtu obligohet që çdo fundvit të përgatis një raport të përgjithshëm vjetor, i cili duhet të publikohet për publikun e gjerë.

Në mënyrë që të përmbushim përgjegjësitë si Sekretariat kemi kërkuar mbështetje nga GIZ-i për të vendosur një metodologji më të qartë dhe një sistem për Monitorim dhe Raportim (M&R). Edhe sistemi i ri i propozuar për M&R ndërtohet mbi matricën ekzistuese. Duke përdorur dhe duke përmirësuar sistemin ekzistues dhe duke përgatitur sistemin e ri, metodologjia e propozuar për M&R përpiket të sigurojë që ne si Sekretariat të jemi në gjendje që të operojmë, menaxhojmë dhe mirëmbajmë sistemin më lehtë.

Ky raport është rezultat i drejtpërdrejt i këtij sistemi të ri në të cilin çdo rezultat që arrihet përditësohet në bazën e të dhënave për monitorim dhe përparimi i arritur rishikohet nga Sekretariati por edhe gjatë takimeve të Këshillit si dhe nga ekipet punuese. Kjo bëhet në pajtim me kornizën kohore të paraparë për aktivitete të caktuara dhe rezultatet e arritura. Kështu, monitorimi është i vazhdueshëm, për t’u siguruar që raportet të kryhen në kohë.

Ky raport shqyrton të arriturat për vitin 2015 si dhe aktivitetet që janë në proces e sipër. Të dhënat janë grumbulluar nga pikat e kontaktit në Ministri, zyrat përgjegjëse në Kryeministri, si përgjegjëse të zbatimit të këtij plani, si dhe koordinatorët e ekipeve dhe bashkëpunëtorët tjerë. Sigurisht, nuk ka munguar as konsultimi dhe koordinimi i Sekretariatit me CiviKos-in, koordinatorët e Ekipeve të Punës dhe vetë ZQM/ZKM si zyrë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të planit.

Ky raport është përpiluar në pajtim me kushtet aktuale dhe pritet të miratohet nga Këshilli. Raporti përfshin periudhën janar- dhjetor 2015 dhe bën vlerësimin e punës së institucioneve për objektivat dhe në fushat në vijim:

Objektivi Strategjik 1 “Pjesëmarrja e siguruar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit”

Përparimi i bërë në këtë drejtim sipas rezultateve të parashikuara - Standardet minimale si sfidë kryesore në këtë objektivë tanimë janë në fazën finale të aprovimit. Zyra Ligjore, Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, CiviKos-i, KCSF, Ekipi i Punës bashkë me partnerët dhe bashkëpunëtorët si GIZ, OSCE, etj. Kanë finalizuar punën për përcaktimin e standardeve minimale për zhvillimin e procesit të konsultimeve publike.

Në rrjedhën e plotësimit të masave dhe aktiviteteve të kësaj objektivë ZQM/ZKM ka zhvilluar bashkëpunim dhe ka marrë pronësinë e projektit e-konsulta të cilin e kanë zhvilluar organizatat “Lens” dhe INDEP. Qëllimi i këtij bashkëpunimi formal në mes të Qeverisë dhe Ekipit e-Konsulta është përdorimi i teknologjisë moderne si mjet për përmirësimin e përfshirjes së Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) në bërjen e politikave dhe proceset e vendimmarrjes në Kosovë. Ky projekt do t’i mundësojë Qeverisë së Kosovës që të krijojë një aplikacion për angazhim në dialog të strukturuar me shoqërinë civile përmes internetit. Ky aplikacion i planifikuar do të përmirësojë dhe lehtësojë konsultimet e institucioneve të qeverisë me shoqërinë civile dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë në rritjen e transparencës së përgjithshme të procesit të krijimit të politikave në Kosovë si dhe mundësinë e OSHC-ve që të ofrojnë kontributin e tyre në këtë proces.

Rregullorja për Standardet minimale për konsultime me publikun ka përfshirë edhe krijimin e bazës së të dhënave dhe zhvillimin e konsultimeve ‘online’ (në internet). Gjithashtu kjo rregullore përcakton edhe krijimin e një sistemi të monitorimit të zbatimit të këtyre standardeve. Pra, kjo platformë do të përfshihet në rregulloren e re, gjë që do të bëjë të obligueshëm për organet qeveritare përdorimin e e-Konsultës. Për më tepër Zyra për Qeverisje të Mirë do të luaj rol monitorues përmes Sekretariatit i cili ndër të tjera, do të mbledhë dhe publikojë të dhëna vjetore në lidhje me konsultimet publike dhe nivelin e kontributit dhe pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile përmes e-Konsultës.

Në draftin e parë të rregullores për standardet është përcaktuar që Sekretariati dhe Këshilli të jenë mekanizma monitorues të zbatimit të standardeve. Gjithashtu Zyra

Ligjore ka identifikuar aktet normative për plotësim të legjislacionit për përfshirjen e Organizatave të Shoqërisë Civile.

Sfidat e përballura në këtë objektivë - ndërlidhja e aktiviteteve me finalizimin e punës për përcaktimin e standardeve minimale për zhvillimin e procesit të konsultimeve publike ka shtyrë zbatimin e aktiviteteve tjera në këtë objektivë.

Hapat tjerë të planifikuar për periudhën e ardhshme raportuese- ZQM/ZKM me përkrahjen e GIZ-it janë në proces të identifikimit të nevojave për trajnime të nëpunësve civil si dhe në proces të dizajnit të përgatitjes së programeve për trajnim. Gjithashtu ky aktivitet do të përkrahet edhe nga KE përmes asistencës teknike që është planifikuar për ZQM/ZKM për vitin 2016. Pas aprovimit të rregullores për standardet minimale për konsultim me publikun do të krijohet mekanizmi mbikëqyrës për zbatimin e standardeve.

Objektivi Strategjik 2 "Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për Organizatat e Shoqërisë Civile"

Përparimi i bërë në këtë drejtim sipas rezultateve të parashikuara- Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm në ZKM është themeluar Ekipi i cili do të punojë në ndërtimin e sistemit të kontraktimit të shërbimeve publike. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit e ka funksionalizuar këtë Ekip. Tashmë është mbajtur edhe takimi i parë, është përcaktuar mandati, janë identifikuar institucionet përgjegjëse si dhe nga të gjitha institucionet janë emëruar pikat e kontaktit të cilët do të jenë pjesë e tij. Në përbërje të këtij ekipi janë anëtarët e Ekipit të Dytë si dhe përfaqësues nga MPMS, MKRS, KRPP, MSH, MTI, MASHT, MD, MBZHR, MeD, MAPL dhe OJQ-ve tjera. Roli i këtij ekipi do të jetë i dyfishtë, nga njëra anë ai do të punojë në hulumtimin e fushave që aktualisht kontraktohen për ofrim të shërbimeve publike nga OSHC, dhe nga ana tjetër do të lehtësoj punën e Ekipit të Dytë, pasi në përbërje ka anëtarë e përfaqësues nga institucionet dhe OJQ-të që kanë përvojë në këtë lëmi. Ky ekip do të analizojë legjislacionin në këtë fushë, listën e ligjeve mbështetëse që prekin këtë sferë dhe do të ndërtojë një sistem për shërbimet publike që ofrojnë OSHC. Llogarisim të arritur edhe krijimin e platformës/bazës së të dhënave e cila siguron informatat mbi profilin e Organizatave të Shoqërisë Civile në bazë të fushave të tyre të veprimit. Janë

identifikuar barrierat ligjore në Ligjin për Prokurim Publik dhe janë përfshirë në draft ligjin e ri për prokurim publik.

Sfidat e përballura- Mungesa e koordinimit të procesit të ekipit të dytë, identifikimi i institucioneve përgjegjëse, legjislacioni jo i harmonizuar në këtë fushë si dhe mungesa e buxhetit janë sfidat që jemi përballuar në realizimin e kësaj objektive.

Hapat tjerë të planifikuar për periudhën e ardhshme raportuese- Ekipi i krijuar do të punoj në hulumtimin e fushave që aktualisht kontrahohen për ofrim të shërbimeve publike nga OSHC. Bazuar në Ligjin e ri të prokurimit do t'i adresojmë sfidat e kontraktimi i shërbimeve.

Objektivi Strategjik 3 : “Sistem i ndërtuar dhe kriteret të përcaktuara për përkrahje financiare për OShC-të”

Përparimi i bërë në këtë drejtim sipas rezultateve të parashikuara- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit për Objektivin Strategjik III “Sistem i ndërtuar dhe kriteret të përcaktuara për përkrahje financiare për OShC-të” ka marrë përkrahje nga projekti TACSO (Technical Assistance for Civil Society Organisations Kosovo Office). ZQM/ZKM bashkë me ekipin janë përcaktuar dhe kanë përgatitur propozimin për Këshillin dhe Qeverinë për modelin e Skemës Nacionale të Granteve. Përmes projektit TACSO- Zyrës për Qeverisje të Mirë i është mundësuar që në këtë proces të jetë prezent një nga ekspertet më të mirë të kësaj fushe në Evropë. Eksperti i angazhuar ka prezantuar dhe rekomanduar për Republikën e Kosovës modelin më të përshtatshëm rreth financimit publik për Organizatat e Shoqërisë Civile. Gjithashtu paraprkasht janë prezantuar praktikat e mira në Ballkanin Perëndimor dhe BE në krijimin e një mjedisi ligjor dhe institucional për OJQ-të, përvojat krahasuese të financimit publik për OJQ-të, si dhe modelet e financimit publik në vendet e rajonit dhe Evropë.

Sfidat e përballura- Disa veprime që nuk kanë qenë në fushëveprimin e MF-së, (ligji për filantropi dhe sponsorizim) MF ka kërkuar nga Sekretariati që ky veprim të trajtohet në një nivel më të lartë – ndërministror. Sekretariati e ka trajtuar këtë çështje dhe me vendim të Sekretarit përgjegjësia i është kaluar MF.

Hapat tjerë të planifikuar për periudhën e ardhshme raportuese- Ekipi i III i Këshillit për zbatimin e Strategjisë bashkë me ZQM/ZKM, Ministrinë e Financave dhe do të punojnë në zhvillimin e modelit MIX të përzgjedhur nga ekipi për financimin e OJQ si dhe aktivitetet tjera të planifikuar në këtë objektiv.

Objektivi Strategjik 4 “Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmi”



Përparimi i bërë në këtë qëllim sipas rezultateve të parashikuara- Është emëruar Ekipi i Përbashkët i Punës për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Kosovës. Ekipi i përbashkët i Punës, është emëruar për përkrahje të Ekipit të IV⁴ të Objektivit Strategjike IV “Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmi”. ZQM/ZKM në një sesion informues të mbajtur në qershor ka mbledhur të gjitha OJQ-të që po punojnë dhe janë të angazhuara në proces të vullnetarizmit dhe ato janë informuar për masat dhe aktivitetet që janë të planifikuar të Objektivit të Katërt të Strategjisë. Bazuar në këtë sesion është krijuar lista dhe janë identifikuar institucionet dhe OJQ-të që punojnë në këtë fushë.

Sfidat e përballura- Sekretariati, ekipi, koordinatori i këtij ekipi dhe vetë MKRS me qëllim që elementet e strategjisë të ecin pikë për pikë, i është drejtuar Ministrisë së Kulturës me një kërkesë për ndalim të punës rreth draft Udhëzimit Administrativë për vullnetarizëm në mënyrë që procesi të mos bie ndesh me strategjinë, e cila përcakton që fillimisht të bëhet një analizë e përgjithshme për sektorin e vullnetarizmit në Kosovë e pastaj bazuar në rekomandimet e analizës dhe punës së Këshillit të përcaktohen veprimet konkrete në këtë drejtim. Por diskutimet ende janë duke u zhvilluar.

Hapat tjerë të planifikuar për periudhën e ardhshme raportuese- ekipi i krijuar do të punoj për të analizuar profilin e vullnetarizmit në Kosovë dhe do të dal me analizë dhe rekomandim se a do të punohet në ligjin e ri për vullnetarizëm apo si do të rregullohet ky proces.

⁴ Qeveria e Kosovës, Këshilli për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, “Vendimi për themelimin e ekipeve punuese për të siguruar zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017”, 10 Nëntor, 2014.

Figura më poshtë paraqet në mënyrë grafike gjendjen aktuale të zbatimit të secilit objektiv gjatë vitit 2015.



Koordinimi dhe Monitorimi i Punës së

Këshillit

ZQM/ZKM si Sekretariati i Këshillit dhe organ përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Bashkë me Këshillin ka hartuar dhe aprovuar Planin e Punës për vitin 2015 për Këshillin. Prioritete e vendosura në këtë Plan janë të bazuara në planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 -2017. ZQM/ZKM gjatë muajve janar – shkurt 2015 ka funksionalizuar edhe mekanizmat përkrahës të Këshillit, ku katër Ekipet e Punës të krijuara me vendim të Sekretari të Përgjithshëm të ZKM që do të kenë për qëllim punën operative dhe teknike të zbatimit të strategjisë kanë marrë hapat dhe nismat për zbatim të planit për të gjitha institucionet të cilat janë përgjegjëse.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si sekretariat i Këshillit për të siguruar zbatimin e Planit të Punës për 2015 të Këshillit për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, ka koordinuar të gjithë punën për mbarëvajtjen e takimeve të Këshillit dhe ekipeve të punës.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka:

- Koordinuar takimet e rregullta të Këshillit
- Koordinuar /bashkërenduar punën e ekipeve punuese
- Monitorimin e zbatimit të strategjisë – raportimi i ekipeve punuese.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si Sekretariat i Këshillit ka bërë përmbledhjen edhe të raportit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë njëherit Planit të Punës së Këshillit dhe i njëjti është prezantuar në korrik 2015. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si Sekretariat i Këshillit ka bërë përmbledhjen e raportit për tremujorin e parë të vitit 2015 për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë njëherit Planit të Punës së Këshillit për vitin 2015.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka funksionalizuar mekanizmat përkrahës të Këshillit. Janë funksionalizuar katër Ekipet e Punës që do të kenë për qëllim punën operative dhe teknike për zbatimin të strategjisë. Janë zgjedhur edhe

koordinatorët e ekipeve të Punës për secilin Objektivin Strategjik. Koordinatorët e ekipeve të punës bashkë me ZQM/ZKM janë përgjegjës të përgatisin raportet, dokumentet dhe kërkesa tjera që dalin nga Këshilli sipas Rregullave të Punës së Këshillit. Janë funksionalizuar katër Ekipet e Punës që do të kenë për qëllim punën operative dhe teknike për zbatimin të strategjisë. Janë zgjedhur edhe koordinatorët e ekipeve të Punës për secilin Objektivin Strategjik. Janë mbajtur takime të rregullta të ekipeve.

Takimet e Këshillit

ZQM/ZKM në bashkëpunim me CiviKos-in dhe koordinatorët e ekipeve të punës ka mbajtur takimet e rregullta të Këshillit:

- Me 15 tetor 2014 /takimi konstituiv i Këshillit; me
- Me 19 dhjetor 2014 – takimi i rregullt i Këshillit;
- Me 21 prill 2015; takimi i rregullt i Këshillit;
- Me 28 korrik 2015, takimi i rregullt i Këshillit;
- Me 22 dhjetor 2015 takimi i rregullt i Punës së Këshillit.

Takimet me koordinatorët e Ekipeve të Punës

Janë zgjedhur koordinatorët e ekipeve të Punës për secilin Objektivin Strategjik. Janë mbajtur takime të rregullta mujore me koordinatorët e ekipeve. Takimet e Koordinatorëve: me 20 janar 2015; me 01 prill 2015; me 07 maj 2015; me 01 korrik 2015; 09 shtator 2015; me 15 dhjetor 2015.

Takimet e Ekipeve të Punës

Ekipi i parë : Me 10 shkurt 2015; me 01 tetor 2015;

Ekipi i dytë II: Me 13 shkurt 2015; me 22 tetor 2015;

Ekipi i III: Me 19 shkurt 2015; me 21-24 maj 2015; 05 tetor 2015;

Ekipi i IV: Me 03.02.2015, me 06 tetor 2015.

Përmbledhje e shkurtë e aktiviteteve që janë realizuar nën koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë

- Është hartuar Plani i Punës për vitin 2015 për Këshillin dhe për ekipet e punës për Objektivat Strategjike dhe i njëjti është miratuar me 19 dhjetor 2015
- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit gjatë muajve janar – shkurt 2015 ka funksionalizuar mekanizmat përkrahës të Këshillit. Janë funksionalizuar katër Ekipet e Punës që do të kenë për qëllim punën operative dhe teknike për zbatimin të strategjisë.
- Janë zgjedhur edhe koordinatorët e ekipive të Punës për secilin objektiv strategjik. Koordinatorët e ekipive të punës bashkë me ZQM/ZKM janë përgjegjës të përgatisin raportet, dokumentet dhe kërkesa tjera që dalin nga Këshilli sipas Rregullave të Punës së Këshillit.
- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit si Sekretariat i Këshillit kemi bërë përmbledhjen e raportit për tremujorin e parë të vitit 2015 për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë njëherit Planit të Punës së Këshillit për vitin 2015.
- Është bërë Lansimin dhe promovimin e Ueb faqes së ZQM/ZKM, për procesin e bashkëpunimi qeveri- shoqëri civile. Është promovuar Ueb faqja e ZQM/ZKM, ku të gjithë qytetarët, institucionet dhe shoqëria civile do ta kenë mundësinë ta përcjellin rrjedhën e këtij procesi përmes komunikimit online.
- ZQM/ZKM ka qenë pjesë në Konferencën rajonale, organizuar nga TACSO, “Monitorimi i Udhëzuesit të BE-së – viti 1” Shoqëri aktive, parakusht për integrim në BE.
- ZQM/ZKM ka qenë pjesë e konferencës bashkë me Lens dhe INDEP “Cikli i politik bërjes në Qeveri dhe Platforma për e-pjesëmarrje bazike, lancuar nga Lens dhe INDEP, fuqizim i bashkëpunimit në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.
- ZQM/ZKM bashkë me CiviKos-in kanë organizuar - Sesion të përbashkët Informues për vullnetarizmin me 29 maj 2015 ZQM/ZKM Sesion informues ku të gjitha OJQ që po punojnë dhe janë të angazhuara në proces të vullnetarizmit janë informuara për masat dhe aktivitetet që janë të planifikuara të Objektiva e Katërt e Strategjisë.

- Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në frymën e bashkëpunimit me partnerë kanë mbajtur takime me z. Nicola Bertolini, Shef i Njesisë së Sektorit D3, Zyra e Komisionit Evropian në Bruksel,
- ZQM/ZKM bashkë me CiviKos-in kanë organizuar punëtori mbi zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile dhe Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë.
- Shkëmbim përvojash mes Zyrës për Qeverisje të Mirë, CiviKos-it dhe ekspertët kroat .
- Vendimi për krijimin e ekipit për vendosjen e sistemit për kontraktim të shërbimeve publike.
- Zhvillimi dhe koordinimi i procesit për përcaktimin e modelit për Skemën Nacionale të Granteve për Shoqëri Civile (SNG) (Fondi Kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile) .
- Përgaditja e Informatorëve - ZQM/ZKM ka përgaditur tre Informator gjatë vitit 2015 për procesin e bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile. Në këta informator janë mbledh informacion dhe material për rrjedhën e procesit të bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile dhe aktiviteteve që janë zhvilluar në koordinimin e Zyrës për Qeverisje të Mirë /Zyrës së Kryeministrit.
- Raportet javor për Sekretarët e Përgjithshëm lidhur me zhvillimet e bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile, ZQM/ZKM çdo javë për mbledhjen e Sekretarëve të Përgjithshëm përgatitë një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve që janë zhvilluar nën koordinimin e ZQM/ZKM për rrjedhën e procesit të bashkëpunimit qeveri –shoqëri civile.

Përfundimet

Sistemi i ri i Monitorimit dhe Raportimit M&R ofron edhe një mundësi të shkëlqyer të konvertimit të rezultateve të arritura në formë të përqindjes për secilën objektiv të realizuar dhe rrjedhimisht për tërë strategjinë si dhe ç'është më e rëndësishmja për buxhetin e shpenzuar. Kështu gjatë periudhës së raportimit është arritur kjo shkallë e realizimit: objektivi i parë 31.8%, objektivi i dytë 42.9%, objektivi i tretë 45.0% si dhe objektivi i katërt 50,0%. Sipas kësaj, realizimi i përgjithshëm i strategjisë për vitin 2015 arrin në vlerën 59.7%. Me këtë rast duhet theksuar se deri në kohën e përpilimit të këtij raporti disa institucione nuk i kanë përfunduar raportimet e tyre. Rrjedhimisht, kjo nënkupton që shkalla e realizueshmërisë së Strategjisë vetëm sa do të rritet sapo të përditësohet baza e të dhënave.

Rekomandimet

- Përgjegjësia më e madhe e institucioneve për zbatim dhe raportim
- Ndarja me kohë e buxhetit të mjaftueshëm për aktivitetet e planifikuara
- Raportimi në lidhje me buxhetin e shpenzuar
- Respektimi i rregullave të raportimit të caktuara nga Këshilli dhe ekipet e punës. Kjo nënkupton raportimin përmes dhe vetëm përmes sistemit të ri për M&R.
- Pjesëmarrje e rregullt në takimet e Këshillit, takimet e koordinatorëve si dhe takimet e ekipeve të punës qoftë nga përfaqësuesit e institucionet qoftë nga ata të shoqërisë civile.
- Sigurimi i stafit shtesë për Sekretariatit gjë që do të rezultojë me përmirësime të mëtutjeshme në mirëmbajtjen, koordinimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me tërë procesin në përgjithësi.

Shtojcat: Përmbledhje e raportit (duke u bazuar në data bazën e të dhënave të Monitorimit).

Shtojcat tjera (me informata shtesë që ndërlidhen me aktivitetet, evidencën e dokumenteve të kompletuara, etj.).

Dëshmitë mbështetëse të secilit rezultat të kryer do të thotë në formën e dokumenteve mund të bashkëngjiten si shtojca. Raporti duhet të jetë i përmbledhur duke iu referuar rezultateve dhe treguesve. Raporti nuk duhet të përfshijë detaje të gjata të aktiviteteve. Raporti duhet t'i referohet treguesve dhe të shpjegojë shkurtimisht përmbajtjen në bazën e të dhënave për monitorim dhe raportim. Raporti mund t'i referohet informatave shtesë të cilat mund të gjenden në internet, si dhe të vendosen në shtojcë detaje lidhur me aktivitetet, minutat e takimeve, hiperlinqet relevante, etj.

Veprimi	Kur duhet të kryhet?	Zbatuar në vitin 2015	Zbatuar në vitin 2016	Zbatuar në vitin 2017 / Gjithsej
<i>Masat të cilat konkretizojnë objektivat e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë civile dhe të cilat zbërthejnë aktivitetet përkatëse</i>	<i>Kur duhet të realizohet aktiviteti saktësisht?</i>	<i>Në ç'masë është arritur ky rezultat? 0.5 =zbatuar pjesërisht,</i>		<i>0= nuk është zbatuar; 1 = zbatuar</i>
Objektivi Strategjik: 1. Pjesëmarrje e siguar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit				
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.1. Hartimi/plotësim-ndryshimi i legjislacionit bazë/referues për përfshirje të OShC në hartim dhe zbatim të politikave				
Indikatori i masës: 1.1. Është hartuar legjislacioni bazë për përfshirje të OShC në hartim dhe zbatim të politikave				
1.1.1. Identifikimi i legjislacionit përkatës për hartim/plotësim-ndryshim	Prill- Qershor 2015	0.5	0	0
1.1.2. Hartimi i akteve normative të identifikuara	Janar - Prill 2015	0.5	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.2. Përcaktimi i standardeve të përfshirjes së OShC në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit				
Indikatori i masës: 1.2. Janë përcaktuar standardet minimale të përfshirjes së OShC				
1.2.1. Krijimi i platformës/databazës e cila siguron informatat mbi profilin e organizatave e shoqërisë civile në bazë të fushave të tyre të veprimit	Prill- Qershor 2015	0.5.	0	0
1.2.2. Përcaktimi i standardeve minimale për konsultime publike	Janar - Prill 2015	1	0	0
1.2.3. Miratimi i aktit rregullativ për standardet minimale për konsultime publike	Prill 2015	0.5	0	0
1.2.4. Promovimi i aktit përkatës për standardet minimale të përfshirjes së OShC	Qershor-Dhjetor 2015	0	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.3. Ngritja e kapaciteteve profesionale të nëpunësve civil dhe pjesëtarëve të OShC në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit				
Indikatori i masës: 1.3. Janë ngritur kapacitetet profesionale të nëpunësve civilë dhe pjesëtarëve të OShC-ve				

1.3.1. Identifikimi i nevojave për trajnime të nëpunësve civil dhe përfaqësuesve të OSHC	Maj -Qershor 2015	0.5	0	0
1.3.2. Hartimi i programeve për trajnim të vazhdueshëm të nëpunësve civilë dhe OSHC	Korrik- Shtator 2015	0	0	0
1.3.3. Organizimi i trajnimeve për nëpunës civilë dhe përfaqësues të OShC	Shtator - Dhjetor 2015	0	0	0
1.3.4. Hartimi i materialeve informuese dhe fushata mediale për vetëdijesim	Shtator -Dhjetor 2015	0	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.4. Ndërtimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe i raportimit për përfshirje të OShC				
Indikatori i masës: 1.4. Është ndërtuar sistemi i mbikqyrjes dhe i raportimit				
1.4.1. Krijimi i mekanizmit për mbikqyrje të zbatimit të standardeve për konsultime publike	Tetor Dhjetor 2015	0.5	0	0
1.4.2 Mbikëqyrja dhe raportimi i vazhduesh përfshirjes së OShC	Nëntor -Dhjetor 2015	0	0	0
Objektivi Strategjik: 2. Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile				
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.1. Hartimi i kornizës ligjore që rregullon procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike nga OShC dhe që përcakton fushat e kontraktimit				
Indikatori i masës: 2.1. Është hartuar korniza ligjore për rregullimin e procedurave të kontraktimit të shërbimeve publike nga OShC				
2.1.1. Themelimi i një grupi të përbashkët për ndërtimin e sistemit për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC	Janar -Mars 2015	1	0	0
2.1.2. Analiza e kornizës ligjore aktuale për rregullimin e procedurave të kontraktimit të shërbimeve publike nga OShC	Mars - Shtator 2015	0.5	0	0
2.1.3. Identifikimi i fushave që OSHC mund të kontraktohen për ofrimin e shërbimeve publike	Mars -dhjetor 2015 2016	0.5	0	0
2.1.4. Identifikimi i organizatave që kanë ekspertizë për ofrimin e shërbimeve të caktuara	Mars Dhjetor 2015	0.5	0	0

2.1.5. Hartimi/plotësim ndryshimi i kornizës ligjore lidhur me ofrimin e shërbimeve publike nga ana e organizatave të shoqërisë civile	2016	N/A	0	0
2.1.6. Hartimi i programit për trajnim të vazhdueshëm të nëpunësve civilë për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC	Dhjetor 2016	0	0	0
2.1.7. Katalogimi i shërbimeve publike që mund të kontraktohen nga OSHC	Dhjetor 2015	0	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.2. Përcaktimi i standardeve dhe parimeve për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC				
Indikatori i masës: 2.2. Janë përcaktuar standardet dhe parimet për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC				
2.2.1. Përcaktimi i standardeve për kontraktim të shërbimeve nga OSHC	2016	N/A	0	0
2.2.2. Akreditimi dhe licensimi i OSHC që mund të ofrojnë shërbime publike	çdo vit	0.5	0	0
2.2.3. Hartimi i doracakut të prokurimit që shpjegon procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike	2016	N/A	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.3. Ndërtimi i mekanizmit të përbashkët i mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve për licencim dhe ofrim të shërbimeve				
Indikatori i masës: 2.3. Është ndërtuar sistemi i mbikëqyrjes				
2.3.1 Institucionet emërojnë komision të përbashkët me OSHC për mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve	2016	N/A	0	0
2.3.2. Hartohen dhe publikohen raporte periodike mbi zbatueshmërinë e standardeve dhe parimeve për kontraktimin e shërbimeve publike nga OSHC	2016	N/A	0	0
Objektivi Strategjik: 3. Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OSHC				
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.1. Reformimi i legjislacionit për zbatim të përbashkët të projekteve				
Indikatori i masës: 3.1. Është hartuar dhe përshtatur legjislacioni për financim të projekteve që zbatohen nga OSHC-të				


3.1.1. Analizë e legjislacionit ekzistues për zbatim të përbashkët të projekteve	Janar - Mars 2015	0.5	0	0
3.1.2. Përshtatja e legjislacionit konform nevojave të identifikuarra përmes analizës	Prill -Dhjetor 2015	0.5	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.2. Krijimi i mjedisit inkurajues për filantropi dhe sponsorizim				
Indikatori i masës: 3.2. Është krijuar ambient i përshtatshëm dhe inkurajues për filantropi dhe sponsorizim				
3.2.1. Hartimi dhe miratimi i ligjit për filantropi dhe sponsorizim	Janar -Dhjetor 2015	0.5	0	0
3.2.2. Përcaktimi dhe harmonizimi i lehtësirave fiskale dhe doganore për filantropë dhe sponsorë	2016	N/A	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.3. Standardizimi i statusit për përfitim publik				
Indikatori i masës: 3.3. Statusi për përfitim publik është përshtatur dhe standardizuar				
3.3.1. Analizë e legjislacionit dhe mekanizmave të statusit të përfitimit publik	Prill - qershor 2015	1	0	0
3.3.2. Plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit për statusin e përfitimit publik	Dhjetor 2015	0.5	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.4. Përfshirja e shoqërisë civile në mekanizmat për koordinim me donatorët				
Indikatori i masës: 3.4. Shoqëria civile është përfshirë në mekanizmat për koordinim me donatorët				
3.4.3. Hapja e mekanizmit ekzistues dhe bazës së të dhënave të donatorëve për kontribut dhe shfrytëzim nga OSHC-të	Janar -qershor 2015	0.5	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.5. Përcaktimi i kriterëve për dhënien dhe zbatimin e granteve nga fondet publike				
Indikatori i masës: 3.5. Grantet nga fondet publike shpërndahen dhe zbatohen në bazë të kriterëve të paracaktuara				
3.5.1. Përcaktimi i modelit të Skemës Nationale të Granteve për Shoqëri Civile (SNG) (Fondi Kombëtar për zhvillimin e shoqërisë civile)	Janar -Dhjetor 2015	1	0	0
3.5.2. Përcaktimi i burimeve të financimit të Skemës Nationale të Granteve (SNG)	2016	N/A	0	0
3.5.3. Përcaktimi i kriterëve për dhënien e granteve nga Skema Nationale e Granteve (SNG)	2016	N/A	0	0
3.5.4. Hartimi dhe miratimi i aktit normativ për Skemën Nationale të Granteve (SNG)	2016	N/A	0	0

3.5.5. Përfshirja e Skemës Nacionale të Granteve në kuadër të KASH	2016	N/A	0	0
3.5.6. Themelimi i Skemës Nacionale të Granteve dhe funksionalizimi i mekanizmit përgjegjës për programimin, shpërndarjen, menaxhimin dhe monitorimin e skemës nacionale të granteve	2016	N/A	0	0
3.5.7. Publikimi i raporteve mbi projektet përfituese, OSHC-të përfituese, dhe rezultatet e projekteve	2016	0	0	0
3.5.8. Përkrahje e projekteve/bashkëfinancim i OSHCve me përqindje të caktuar për fondet e BE-së për shoqëri civile	Janar Qershor 2015	0	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.6. Përcaktimi i kriterëve për përkrahjen jo financiare për OShC				
Indikatori i masës: 3.6. Kriteret për përkrahjen jo financiare për OShC janë përcaktuar				
3.6.1. Analiza e legjislacionit të tanishëm që rregullon mënyrën e përkrahjes jo-financiare	Janar -Dhjetor 2015	0	0	0
3.6.2. Plotësimi-ndryshimi i pakos ligjore për përkrahje jo-financiare të OSHC	2016	N/A	0	0
Objektivi Strategjik: 4. Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit				
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.1. Identifikimi i nevojave dhe profilit të vullnetarizmit në Kosovë				
Indikatori i masës: 4.1. Nevojat dhe profili i vullnetarizmit në Kosovë janë identifikuar				
4.1.1. Identifikimi i aktorëve përgjegjës	Janar - Mars 2015	1	0	0
4.1.2. Themelimi i grupit ndërsektoral për vullnetarizëm	Janar -Mars 2015	0.5	0	0
4.1.3. Analizimi i profilit të vullnetarizmit në Kosovë	Prill - Dhjetor 2015	0	0	0
4.1.4. Zbatimi i rekomandimeve të dala nga analiza	2016	N/A	0	0
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.2. Ndërtimi i sistemit të mbikëqyrjes dhe i raportimit për vullnetarizëm				
Indikatori i masës: 4.2. Është ndërtuar sistemi i mbikëqyrjes dhe i raportimit				
4.2.1. Krijimi i mekanizmit për mbikëqyrje të zbatimit e qasjes së integruar për vullnetarizëm	2016	N/A	0	0
4.2.2. Mbikëqyrja dhe raportimi i vazhdueshëm i zbatimit e qasjes së integruar për vullnetarizëm	2016	N/A	0	0

Zbatimi i strategjisë në %	40.3%	0.0%	0.0%
Mos zbatimi I strategjisë në %	59.7%	100.0%	100.0%

% e zbatimit të secilit objektiv			
Objektivi 1. Pjesëmarrja e shoqërisë civile	31.8%	0.0%	0.0%
Objektivi 2. Kontraktimi i shërbimeve publike për OJQ-të	42.9%	0.0%	0.0%
Objektivi 3. Përkrahja Financiare për OJQ-të	45.0%	0.0%	0.0%
Objektive 4. Vullnetarizmi	50.0%	0.0%	0.0%

Zbatimi i Strategjisë në vitin 2015 (%)



Zbatimi i secilit objektiv në vitin 2015 (%)

